

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Xhevahire Kloepner & Associates“SH.P.K. ” SH.P.K**

Sot, më datë 01/07/2023(dy mijë e njezet e tre), **Znj.XHEVAHIRE KLOEPPNER**, shtetas i Kosoves, i datëlindjes 10/07/1962, lindur në Komuna Kline(Pjetërç), dhe banues në Kosove Prishtine ,rruga Xhorxh Bush ndertesë47/8 kodi postar 10000 , person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes me id 1685388 dhe nr 1234196339 Vendosem te themelojme nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat vijuese.

**NENI 1**  
**Themelimi**

Emri i shoqerise eshte **Xhevahire Kloepner & Associates“SH.P.K.**, Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri ” **SH.P.K.**, sipas përcaktimeve të bëXhevahire Kloepner & Associates“SH.P.Kz te bera në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

**NENI 2**

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie eshte aktivitet fitimprures ne fushen juridike .

**NENI 3**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin ”Xhevahire Kloepner & Associates“SH.P.K.. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë është: Veprimtari juridike ne te gjitha drejtimet tregtare , administrative , civile, dhepenale etj .

Cdo operacion te ngjashem dhe te lejuar nga legjislacioni shqiptar

**NENI 5**

**Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në bashkinë Tirane , Adresa Tirane njesia bashkiake nr 7 rruga Nikolla Lena is markata vjeter nr 9 zhvillon aktivitetin e saj per një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 6**

**Kapitali i Shoqërisë dhe Ortaket**

Kapitali i shoqërisë: është në vlerën 100.000 (nje qind mijë) lek, Ortaku themelues **Znj.XHEVAHIRE KLOEPPNER**te Shoqërisë Tregtare “Xhevahire Kloepner & Associates“SH.P.K. zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:-**Znj.XHEVAHIRE KLOEPPNER**, shtetas Kosoves, i datëlindjes 10/07/1962 lindur në komune Kline, dhe banues në Kosove Prishtine ,Rruga Xhorxh Bush ndertesë 47/8 kodi postar 10000 mbajtës i pashaportes me id 1685339 me numer 1234196339 zotërues i kuotave 100 % të përbërë nga 100.000(njeqind mijë) lek, duke

përfaqesuar 100 %, të kapitalit **Z.**, Kapitali themeltar eshte shlyer plotesisht ne para nga Ortaket me themelimin e Shoqerise. Pergjegjesia e ortakeve shtrihet deri ne shumen e kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar

#### **NENI 7 Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;  
Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

#### **NENI 8 Administratori**

Shoqëria administrohet nga 1 Administratore i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administratori i shoqërisë do të jetë **Znj.XHEVAHIRE KLOEPPNER** shtetas shqiptar i datelindjes 10/07/1962 lindur në KLINE (Pjetërq ), dhe banues në Kosove ,Prishtine ,Rruga Xhorxh Bush nertesa 47/8 mbajtes i nr karte 1234196339 shtetas Shqiptar,

#### **NENI 9**

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, te cili ushtronë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 10**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 12**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 13**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### **NENI 14**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkruan pa urrejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKU THEMELUES  
Znj.XHEVAHIRE KLOEPPNER**

*Xhevahire Kloeppner*

*[Signature]*